



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008, si dhe neneve 3, 6 dhe 7 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve nga buxheti i Komunës 15Nr.-011-23133 e datës 06.05.2015, Kryetari i Komunes duke vendosur sipas kërkesës së OJQ “Dritarja “ të datës 13.10.2016, nxjerr

VENDIM PËR MBËSHTETJE FINANCIARE

Neni 1

I ndahet shuma e mjeteve në vlerë prej 1000 € (një mijë euro), OJQ -së “Dritarja” në Lipjan , sipas kërkesës së tyre të datës 13.10.2016, për ta mbështetur financiarisht në realizimin e projektit “Muaji kundër kancerit”.

Neni 2

Shuma e cekur nga neni 1 do të paguhet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2016, pozicioni buxhetor- subvencionet e planifikuara për Zyrën e Kryetarit të Komunës në xhirollogarinë bankare nr.1901368474031155 në BKT.

Neni 3

Lidhur me mjetet e shpenzuara, OJQ duhet të sjell raportin financiar duke i bashkëngjitë faturat. Raporti dorëzohet në Sektorin për përfaqësim dhe çështje ligjore më së largu me datë 30.12.2016, i cili duhet të jetë në përputhje me nevojat e paraqitura në Kërkesë.

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset, Zyra e Kryetarit të Komunës dhe Drejtorati për Buxhet dhe Financa.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëtin do të njoftohet OJQ “Dritarja” .

1Nr. 400 - 56979

Lipjan, më 14.10.2016

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti